



'VATRA' I SHKRUAN PRESIDENTIT TRUMP: T'I JEPET FUND PADREJTËSISË NË HAGË

FAQE 4-5



Federata Pan-Shqiptare e Amerikës "VATRA" i është drejtuar me një letër presidentit të ShBA-së, Donald Trump, duke kërkuar ndërhyrjen e tij diplomatike për t'i dhënë fund proceseve gjyqësore ndaj liderëve të UÇK-së në Hagë. Në letër është theksuar se UÇK-ja ishte një forcë e

lindur nga nevoja për mbrojtjen e një populli të përballur me shtypje, dëbime dhe dhunë sistematike nga regjimi i Slobodan Millosheviqit. "VATRA" i ka bërë thirrje presidentit Trump që, në emër të drejtësisë, sovranitetit dhe partneritetit historik ndërmjet Kosovës dhe

Amerikës, ta rishikojë qasjen ndaj Gjykatës Speciale në Hagë. "VATRA", ka vlerësuar se proceset ndaj liderëve të UÇK-së rrezikojnë jo vetëm të cenojnë drejtësinë historike, por edhe të ndikojnë në stabilitetin dhe paqen në Ballkanin Perëndimor

**KOSOVA RREZIKON
HUMBJEN E FONDEVE
TË BE-SË PËR SHKAK
TË RITMIT TË
NGADALTË TË
REFORMAVE** F. 3



**BE-ja NËN PRESION
PËR ZGJERIM, RAMA
PËR 'FINANCIAL
TIMES': SHQIPËRIA
NDODHET NË
MOMENTIN MË TË MIRË** F. 3



AKTUALE



**LATIFI: LARGIMI I ALI AHMETIT NGA
PUSHTETI ISHTE MARRËZI, HISTORIA
SHQIPTARE DO TA MBAJË MEND** F. 3

**ZELENSKY SHKARKON
AMBASADORËT E UKRAINËS NË
SHQIPËRI, KROACI DHE MAL TË ZI** F. 2

**DORËHEQJET E GJYQITARËVE SERBË,
DËSHTON SËRISH MBLEDHJA E
KGJK-së** F. 6

EKONOMI



**PENSIONISTËT E KOSOVËS:
PENSIONET NUK PO MJAFTOJNË
PËR SHPENZIMET BAZË** F. 8

**ASK-ja: RRIKET NUMRI
I VIZITORËVE NË HOTELET
E KOSOVËS GJATË MUAJIT
QERSHOR** F. 8

SPORT



**NIS SEMINARI I FIFA-s
PËR GJYQITARËT E FUTBOLLIT
TË KOSOVËS** F. 10

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

**Kolegji
BIZNESI**
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SHA
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Zelensky shkarkon ambasadorët e Ukrainës në Shqipëri, Kroaci dhe Mal të Zi

Kiev, 7 gusht - Presidenti i Ukrainës, Volodymyr Zelensky, ka shkarkuar ambasadorët e vendit në Kroaci, Shqipëri dhe Mal të Zi. Vendimet për lirim të tyre nga detyra janë publikuar në dekrete të veçanta presidenciale. “Sipas dekretit nr. 709/2026, nga posti është shkarkuar Vasyl Kyrlych,

ambasador i Ukrainës në Kroaci. Me dekretin nr. 710/2026, Zelensky i ka dhënë fund mandatit të Volodymyr Shkurov, i cili shërbente si ambasador në Shqipëri që nga prilli i vitit 2020. Me dekretin nr. 711/2026 është përfunduar edhe mandati diplomatik i Oleh Herasymenkos si ambasador në

Mal të Zi”, është thënë në njoftim. Këto ndryshime vijnë pasi më 3 gusht, Zelensky shkarkoi edhe ambasadorin e Ukrainës në Shtetet e Bashkuara, Olha Stefanishyna. Disa ditë pas shkarkimit të saj, Gjykata e Lartë Kundër Korrupsionit ka vendosur ndaj Stefanishynës

masën e sigurisë me kusht pagese të një garancie prej 6 milionë hryvni, rreth 134 mijë dollarë amerikanë. Ajo dyshohet për pasurim të paligjshëm dhe deklarim të rremë të pasurisë. Vetë Stefanishyna ka deklaruar se nuk ka mjete të mjaftueshme financiare për të paguar garancinë e caktuar nga gjykata.



TRUMPI KUFIZON SHTETËSINË PËR FËMIJËT E LINDUR NË SHBA, SFIDON AMENDAMENTIN E 14-të

WASHINGTON, 7 GUSHT - Presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA), Donald Trump, ka nënshkruar dy urdhra ekzekutivë që synojnë kufizimin e të drejtës për shtetësi automatike për fëmijët e lindur në territorin amerikan, duke sfiduar interpretimin aktual të Amendamentit të 14-të të Kushtetutës së ShBA-së. Kufizimi i kësaj të drejte është një nga prioritetet kryesore të administratës Trump në kuadër të politikave kundër emigracionit. Masat e reja synojnë veçanërisht fenomenin

e njohur si “turizmi i lindjes”, kur gra shtatzëna nga vende të tjera udhëtojnë drejt ShBA-së për të lindur, me qëllim që fëmijët e tyre të përfitojnë shtetësinë amerikane. Urdhrat e rinj parashohin gjithashtu kufizime për fëmijët e lindur nga punonjës të qeverive të huaja në ShBA, si dhe për fëmijët e personave të klasifikuar nga autoritetet amerikane si “armiqtë e huaj”. Vendimi i Trumpit vjen pasi më 30 qershor Gjykata Supreme ka rrëzuar si antikushtetues një urdhrë të mëparshëm të tij, i cili



synonte t’u mohonte shtetësinë fëmijëve të lindur në ShBA nga prindër që ndodheshin në vend në mënyrë të paligjshme ose me status të përkohshëm. Administrata amerikane argumenton se urdhrat e rinj janë më të kufizuar dhe nuk bien ndesh me vendimin e gjykatës. Megjithatë, ekspertët e të drejtës dhe organizatat për mbrojtjen e të drejtave të emigrantëve kanë paralajmëruar se edhe këto masa pritet të përballen me sfida ligjore në gjykata. Sipas

tyre, Amendamenti i 14-të garanton shtetësinë për pothuajse çdo person të lindur në territorin amerikan dhe një president nuk mund ta ndryshojë këtë të drejtë vetëm përmes një urdhri ekzekutiv. Gjatë ceremonisë së nënshkrimit të urdhrave në Shtëpinë e Bardhë, Trump e ka cilësuar vendimin e Gjykatës Supreme si “shumë të gabuar”, duke deklaruar se “njerëzit po ndërtojnë biznese rreth turizmit të lindjes” dhe se administrata e tij synon t’i japë fund kësaj praktike.

SENATORËT AMERIKANË KËRKOJNË RIVENDOSJEN E SANKSIONEVE NDAJ ZYRTARËVE TË REPUBLIKËS SËRPSKA

WASHINGTON, 7 GUSHT - Një grup senatorësh amerikanë, republikanë dhe demokratë, i kanë bërë thirrje administratës së presidentit Donald Trump që të rivendosë sanksionet ndaj zyrtarëve të Republikës Sërpska, të cilat ishin hequr në tetor të vitit 2025. Kërkesa e tyre vjen pas veprimeve të autoriteteve në entitetin e Republikës Sërpska në Bosnje e Hercegovinë, të cilat morën në pyetje punonjës dhe ish-punonjës të Qendrës Përkujtimore të Potoçarit, të përfshirë në përgatitjen e një raporti për mohimin e gjenocidit. Përmes një deklarate, senatorët janë shprehur “thellësisht të shqetësuar” për marrjen në pyetje të 26 punonjësve, ish-punonjësve dhe bashkëpunëtorëve të Qendrës Përkujtimore, duke vlerësuar se veprimet e tilla mund të cenojnë punën e institucionit

për ruajtjen e së vërtetës dhe nderimin e viktimave. “Shkalla dhe koha e këtyre veprimeve janë shqetësuese, veçanërisht sepse puna e Qendrës Përkujtimore është kyç për ruajtjen e së vërtetës, nderimin e viktimave dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut. U bëjmë thirrje autoriteteve përkatëse që të respektojnë sundimin e ligjit, pavarësinë e institucioneve të Bosnje e Hercegovinës dhe të sigurojnë që Qendra Përkujtimore të mund ta përmbushë misionin e saj thelbësor, pa u përballur me frikësim”, është thënë në reagimin e senatorëve. Në deklarata, ata kanë kërkuar nga administrata amerikane zbatimin e sanksioneve të miratuara në kuadër të Aktit të Autorizimit të Mbrojtjes Kombëtare, duke theksuar se institucionet

amerikane e kanë cilësuar masakrën e Srebrenicës si gjenocid. “Më shumë se 30 vjet më vonë, kemi një përgjegjësi t’i kujtojmë viktimat, të qëndrojmë pranë familjeve të tyre dhe të sigurojmë që kjo histori tragjike të mos mohohet apo fshihet. Rishkrimi i historisë për përfitime politike thellon ndasitë, nxit tensionet etnike dhe kërcënon paqen dhe stabilitetin në Bosnje e Hercegovinë”, kanë deklaruar senatorët. Ata kanë kërkuar që individët përgjegjës për veprime destabilizuese dhe cenim të institucioneve demokratike të mbahen përgjegjës. Prokuroria Publike e Qarkut në Bielinë ka konfirmuar më herët se ka hapur një rast për verifikimin e informacioneve dhe kallëzimit që lidhen me veprimtarinë e Qendrës Përkujtimore të



Srebrenicës gjatë vitit 2022. Sipas prokurorisë, rasti është në fazën e verifikimeve për shkak të dyshimeve për shmangie të tatimeve dhe kontributeve. Prokuroria në Republikën Sërpska ka bërë të ditur se deri më tani nuk ka nxjerrë urdhrë

për hetim dhe se personat janë marrë në pyetje në cilësinë e dëshmitarëve. Drejtori i Qendrës Përkujtimore të Srebrenicës, Emir Sulagiq, ka paralajmëruar vazhdimisht për presionet nga institucionet e Republikës Sërpska, veçanërisht për aktivitetet që lidhen me dokumentimin e gjenocidit dhe mohimit të tij. Autoritetet e Republikës Sërpska, përfshirë zyrtarët më të lartë politikë, prej vitesh mohojnë aktgjykimet e gjykatave ndërkombëtare dhe vendore për gjenocidin në Srebrenicë. Qendra Përkujtimore e Srebrenicës, e hapur në vitin 2003 në ish-bazën e Kombeve të Bashkuara, është institucion shtetëror që përqendrohet në ruajtjen e kujtesës për më shumë se 8 mijë boshnjakë të vrarë gjatë gjenocidit të korrikut të vitit 1995.

Gjermania forcon sigurinë në aeroporte, vendos sisteme kundër dronëve

BERLIN, 7 GUSHT - Gjermania ka nisur instalimin urgjent të sistemeve të avancuara kundër dronëve në aeroportet kryesore të vendit, me qëllim rritjen e sigurisë së trafikut ajror dhe parandalimin e kërcënimeve të mundshme. Tetë aeroportet më të mëdha gjermane: Frankfurt, Berlin,

Mynih, Düsseldorf, Stuttgart, Hamburg, Leipzig dhe Köln janë duke u pajisur me teknologji të reja për zbulimin dhe neutralizimin e dronëve të paautorizuar. Vendimi vjen pas një serie incidentesh të lidhura me përdorimin e dronëve pranë zonave aeroportuale, raporton “CNN”.

Rasti më i fundit ka shkaktuar alarm në Leipzig, ku, sipas raportimeve, është zbuluar një dron që dyshohej se transportonte eksplozivë pranë një avioni ukrainas të ngarkesave. Autoritetet gjermane e konsiderojnë mbrojtjen kundër dronëve si një prioritet të ri të sigurisë,

pasi pajisje të tilla mund të paraqesin rrezik serioz për avionët, pasagjerët dhe funksionimin normal të aeroportëve. Pritet që shumica e aeroportëve kryesore të Gjermanisë të jenë të pajisura me sistemet e reja të mbrojtjes deri në fund të këtij viti.



KOSOVA RREZIKON HUMBJEN E FONDEVE TË BE-së PËR SHKAK TË RITMIT TË NGADALTË TË REFORMAVE

Prishtinë, 7 gusht - Zbatimi i reformave të përcaktuara nga Plan i Rritjes i Bashkimit Evropian (BE) për Ballkanin Perëndimor po ecën me ritme të ngadalta në Kosovë, ndërsa mosrespektimi i afateve të përcaktuara mund të çojë në humbjen e një pjese të mjeteve të ndara për vendin. Të dhënat e publikuara nga “WeBalkans” tregojnë se shtetet e Ballkanit Perëndimor kanë shënuar nivele të ndryshme të përparimit, ndërsa Kosova dhe Bosnjë e Hercegovina renditen ndër vendet me ecurinë më të dobët në realizimin e reformave. Nga shuma fillestare prej 882.6 milionë eurosh, e paraparë për Kosovën përmes Planit të Rritjes, deri tani vendi ka përfituar 61.8 milionë euro. Materiali, të cilit i referohet “Kosovapress”, thekson se pas miratimit të Agjendës së Reformave nga Komisioni

Evropian, Kosova ka nisur miratimin e legjislacionit të ri, zbatimin e ndryshimeve institucionale, digjitalizimin e administratës publike dhe avancimin e menaxhimit të financave publike. Megjithatë, ecuria e këtij procesi vlerësohet si e ngadaltë. Një zëdhënës i Komisionit Evropian, i cituar në publikimin e “WeBalkans”, ka bërë me dije se vetëm Kosova dhe Bosnjë e Hercegovina nuk e kanë dorëzuar ende raportimin zyrtar për zbatimin e reformave. “Vetëm Bosnjë e Hercegovina dhe Kosova nuk kanë raportuar ende formalisht për zbatimin e reformave”, ka thënë zëdhënësi i Komisionit Evropian. Brukseli ka sqaruar se ndarja e fondeve është e lidhur drejtpërdrejt me përbushjen e reformave për të cilat është rënë dakord, ndaj vendet e rajonit duhet t'i realizojnë detyrimet brenda



afateve të përcaktuara. Duke përcjellë qëndrimin e Komisionit Evropian, në material thuhet se “Pagesat janë të kushtëzuara me përbushjen e hapave të reformave”. Në rast të vonesave, shteteve u

jepet një periudhë shtesë për realizimin e kushteve. Por nëse detyrimet nuk përbushen as gjatë këtij afati, fondet përkatëse rrezikojnë të humben. Komisioni Evropian ka paralajmëruar, sipas

“WeBalkans”, se “nëse kushtet nuk përbushen brenda periudhës shtesë, shuma përkatëse mund të humbet dhe të rialokohet te përfituesit e tjerë në vitet pasuese”. Projektet e financuara përmes Planit të Rritjes duhet të përmbyllen deri në fund të vitit 2027, ndërsa Komisioni Evropian ka bërë të qartë se nuk është paraparë shtyrje apo zgjatje e këtij afati. Përmes Planit të Rritjes për Ballkanin Perëndimor synohet afrimi ekonomik i vendeve të rajonit me Bashkimin Evropian, përmes integritimit gradual në tregun e përbashkët evropian, fuqizimit të bashkëpunimit ekonomik rajonal dhe përshejtitimit të reformave themelore. Sigurimi i fondeve nga Mekanizmi për Reforma dhe Rritje kushtëzohet drejtpërdrejt nga zbatimi i hapave të përcaktuar në agjendën e reformave të secilit shtet.

LATIFI: LARGIMI I ALI AHMETIT NGA PUSHTETI ISHTE MARRËZI, HISTORIA SHQIPTARE DO TA MBAJË MEND

Prishtinë, 7 gusht - Profesori universitar Blerim Latifi, ka vlerësuar se largimi nga pushteti i liderit të Bashkimit Demokratik për Integrim (BDI), Ali Ahmeti, përbën një gabim historik me pasojë për pozitën e shqiptarëve në Maqedoninë e Veriut. Përmes një postimi në “Facebook”, Latifi e ka cilësuar Ahmetin si “mohikanin e fundit” të platformës së Rilindjes Kombëtare Shqiptare në politikën shqiptare në Maqedoninë e Veriut. “Turravrap nga brenda Maqedonisë dhe nga disa qarqe politike të Kosovës për ta defaktorizuar e larguar nga pushteti ishte një marrëzi, që historia shqiptare do ta mbajë mend pikërisht si të tillë. Kjo marrëzi suicidale ua hapi rrugën e sigurt sllavëve maqedonas për të filluar procesin e përmbysjes

graduale të krejt asaj që arritën shqiptarët pas vitit 2001. Sot, forcat e rezistencës shqiptare kundër këtij procesi në Maqedoni janë fare të pakta”, ka shkruar Latifi. Ai është shprehur se Ahmeti, si një nga themeluesit e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) dhe themelues e drejtues i Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare (UÇK), ka përfaqësuar një projekt politik të ndërtuar mbi idealet e Rilindjes Kombëtare. Sipas Latifit, përpjekjet për ta defaktorizuar dhe larguar Ahmetin nga pushteti, si nga brenda Maqedonisë së Veriut ashtu edhe nga disa qarqe politike në Kosovë, kanë qenë një veprim i gabuar që, sipas tij, do të mbahet mend nga historia. Ai është shprehur se kjo, sipas tij, u ka krijuar hapësirë forcave

politike maqedonase për të nisur një proces të zhbërjes graduale të arritjeve të shqiptarëve pas konfliktit të vitit 2001. Latifi ka vlerësuar se aktualisht rezistenca shqiptare ndaj këtij procesi është e dobët, ndërsa ka shprehur shqetësimin për ndikimin që, sipas tij, po ushtrojnë nacionalizmi maqedonas dhe ideologjitë fetare në politikën shqiptare në Maqedoninë e Veriut. Latifi ka bërë një krahasim me shqiptarët e Novi Pazarit dhe Malit të Zi, duke paralajmëruar se, sipas tij, shqiptarët në Maqedoninë e Veriut mund të përballen me pasojë të ngjashme në aspektin e identitetit kombëtar. “Nacionalizmi maqedonas, në aleancë me ideologjinë e Muslim Brotherhood, e cila ka shtrirë



tentakulat e saj në çdo pore të popullatës shqiptare, janë duke e varrosur nacionalizmin shqiptar në Maqedoni. Një ditë do të vajtjomë për ta, ashtu siç vajtjomë sot për shqiptarët e

Novi Pazarit dhe të Malit të Zi, të cilët kombinimi i fesë me politikën diskriminuese serbe e malazeze i kishte shndërruar nga shqiptarë në boshnjakë.”, ka shkruar Latifi.

BE-ja NËN PRESION PËR ZGJERIM, RAMA PËR ‘FINANCIAL TIMES’: SHQIPËRIA NDODHET NË MOMENTIN MË TË MIRË

TIRANË, 7 GUSHT - Pas 13 vitesh pa pranuar asnjë anëtar të ri, Bashkimi Evropian (BE) po përballlet me presion në rritje për të rihapur procesin e zgjerimit, në një kohë kur pasiguritë gjeopolitike dhe konkurrenca mes fuqive të mëdha po intensifikohen. Pavarësisht përpjekjeve të Brukselit për të shfaqur unitet dhe siguri kolektive përballë sfidave ndërkombëtare, brenda BE-së vazhdojnë debatet dhe dilemat mbi gatishmërinë e bllokut për të përfshirë vende të reja. Liderët e vendeve kandidatë kërkojnë përshejtim të procesit të anëtarësimit, ndërsa disa qeveri të

vendeve anëtare shprehin shqetësime nëse strukturat aktuale të Bashkimit dhe opinionin publik në vendet e tyre janë të gatshme për një zgjerim të ri. Pas pushtimit rus të Ukrainës, zgjerimi i BE-së ka marrë një dimension të ri strategjik, duke u parë jo vetëm si proces politik dhe ekonomik, por edhe si çështje sigurie. Kjo ka rikthyer shpresat për përparim pas një dekade të karakterizuar nga ngadalësimi i procesit. Mali i Zi, vendi që konsiderohet më afër anëtarësimit, ka përfunduar më shumë se gjysmën e reformave të kërkuara për hyrje në BE. Institucionet evropiane



kanë nisur përgatitjet për hapat ligjorë të anëtarësimit, ndërsa vendi është përfshirë edhe në planet financiare të bllokut. Ndërkohë, Ukraina dhe Moldavia kanë nisur negociatat zyrtare të anëtarësimit, ndërsa Shqipëria ka shënuar përparim në procesin e

reformave për afrimin me Bashkimin Evropian. Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka deklaruar se vendi ndodhet në një moment të rëndësishëm në rrugën drejt integritimit evropian. “Ne kemi një rrugë të qartë drejt Bashkimit Evropian. Shqipëria është në momentin më të mirë në shumë aspekte”, është shprehur Rama për “Financial Times”. Megjithatë, disa vende kandidatë po shfaqin dyshime nëse premtimet e Brukselit do të përketohen realisht në anëtarësim. Debatet për ndryshimin e procesit të zgjerimit, përmes një integritimi më gradual,

është parë nga disa kandidatë si rrezik për krijimin e një sistemi me nivele të ndryshme anëtarësimi. Në Ballkanin Perëndimor, përveç Malit të Zi dhe Shqipërisë, vendet e tjera kandidatë si Serbia, Maqedonia e Veriut, Bosnje-Hercegovina dhe Kosova kanë shënuar më pak përparim vitet e fundit. Disa zyrtarë evropianë shprehin shqetësim për hendekun mes deklaratave pro-zgjerimit nga drejtuesit e BE-së dhe realitetit në terren, pasi edhe vendet më të avancuara mund të jenë ende disa vite larg anëtarësimit të plotë. Megjithatë, zërat që kërkojnë një vendim më të qartë për zgjerimin po shtohen.



‘VATRA’ I SHKRUAN PRESIDENTIT TRUMP: T’I JEPET FUND PADREJTËSISË NË HAGË

Federata Pan-Shqiptare e Amerikës “VATRA” i është drejtuar me një letër presidentit të ShBA-së, Donald Trump, duke kërkuar ndërhyrjen e tij diplomatike për t’i dhënë fund proceseve gjyqësore ndaj liderëve të UÇK-së në Hagë. Në letër është theksuar se UÇK-ja ishte një forcë e lindur nga nevoja për mbrojtjen e një populli të përballur me shtypje, dëbime dhe dhunë sistematike nga regjimi i Slobodan Millosheviqit. “VATRA” i ka bërë thirrje presidentit Trump që, në emër të drejtësisë, sovranitetit dhe partneritetit historik ndërmjet Kosovës dhe Amerikës, ta rishikojë qasjen ndaj Gjykatës Speciale në Hagë. “VATRA”, ka vlerësuar se proceset ndaj liderëve të UÇK-së rrezikojnë jo vetëm të cenojnë drejtësinë historike, por edhe të ndikojnë në stabilitetin dhe paqen në Ballkanin Perëndimor

ShBA-së për të rishikuar mandatin e kësaj gjykate, për t’i dhënë fund, sipas tij, tejkalimit të kompetencave të saj dhe për të mbështetur lirin e Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit. Në letër, Berisha ka theksuar se mbrojtja e atdheut nga gjenocidi nuk duhet të konsiderohet kurrë krim dhe e ka falënderuar presidentin Trump për mbështetjen e vazhdueshme ndaj popullit të Kosovës.

Letra e plotë:

*I nderuari Donald J. Trump
President i Shteteve të Bashkuara të Amerikës
Shtëpia e Bardhë
1600 Pennsylvania Avenue,
N.W. Washington, DC 20500
6 gusht 2026*

I nderuar president Trump,
Me respekt ju drejtoj këtë kërkesë për udhëheqjen tuaj vendimtare dhe ndërhyrjen tuaj diplomatike lidhur me proceset gjyqësore që vazhdojnë në mënyrë të motivuar politikisht ndaj drejtuesve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) në Dhomat e Specializuara në Hagë. Si një lider që vazhdimisht ka mbështetur sovranitetin

kombëtar, ka kundërshtuar tejkalimin e kompetencave nga tribunale ndërkombëtare të papërgjegjshme dhe ka kontribuar në arritje të rëndësishme diplomatike në Ballkan, ju keni mundësinë të ndihmoni në përfundimin e kësaj padrejtësie të thellë historike.

Zoti president,
Ndjekja penale ndaj udhëheqësve të Kosovës rrezikon të rishkruajë historinë e një lufte të drejtë dhe të destabilizojë një aleat të rëndësishëm të Shteteve të Bashkuara. Si president i Federatës Pan-Shqiptare të Amerikës “VATRA”, organizata më e vjetër shqiptare në ekzistencë, ju kërkoj të merrni parasysh këto realitete historike, politike dhe diplomatike:

Domosdoshmëria morale

Lufta në Kosovë nuk ishte një përplasje mes agresorësh të barabartë; ajo ishte një fushatë sistematike e spastrimit etnik e ndërmarrë nga aparati shtetëror i Slobodan Millosheviqit kundër një popullsie civile të pafajshme. UÇK-ja u krijua si një forcë vullnetare dhe mbrojtëse, e

**EPOKA
ERE****Lirim GECI**

PRISHTINË, 7 GUSHT - Kryetari i Federatës Pan-Shqiptare të Amerikës “VATRA”, Elmi Berisha, i ka dërguar një letër presidentit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA), Donald Trump. Në këtë letër, Berisha ka vlerësuar se gjykimi i liderëve të UÇK-së, Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit rrezikon të rishkruajë historinë e luftës çlirimtare të Kosovës dhe të dëmtojë një aleat të rëndësishëm të Shteteve të Bashkuara në Ballkan. Berisha ka vë në pah se lufta në Kosovë nuk ishte një konflikt mes palëve

të barabarta, por një fushatë sistematike e spastrimit etnik e regjimit të Slobodan Millosheviqit ndaj popullsisë shqiptare, ndërsa UÇK-ja u krijua si forcë mbrojtëse për të parandaluar shfarosjen e shqiptarëve të Kosovës. Në letër vihen në dukje mbi 15 mijë civilë shqiptarë të vrarë, rreth 25 mijë viktima të dhunës seksuale gjatë luftës dhe mbi një milion të zhvendosur, duke shtuar se kriminalizimi i drejtuesve të UÇK-së cenon kujtesën e viktimave dhe drejtësinë historike. Më tutje, Berisha ka nënvizuar lidhjen e ngushtë ndërmjet Kosovës dhe Shteteve të Bashkuara, duke e cilësuar Kosovën si vendin më

proamerikan në botë. Ai ka shkruar se procesi në Hagë dobëson këtë partneritet strategjik dhe dërgon mesazhin se aleatët e ShBA-së mund të lihen në mëshirën e tribunaleve ndërkombëtare që, sipas tij, nuk pasqyrojnë vlerat amerikane të drejtësisë dhe sovranitetit. Në letër është vlerësuar edhe roli i presidentit Trump në Ballkan, veçanërisht marrëveshja e Uashingtonit e vitit 2020 dhe njohja e Kosovës nga Izraeli. Berisha pretendon se Serbia dhe Rusia po e përdorin procesin në Hagë për propagandë kundër shtetësisë së Kosovës dhe ndikimit amerikan në rajon. Ai i kërkon Presidentit Trump të përdorë ndikimin diplomatik të

LV-ja DHE LDK-ja DËSHTOJNË TË ARRIJNË MARRËVESHJE POLITIKE

Prishtinë, 7 gusht - Lëvizja Vetëvendosje (LV) dhe Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), kanë dështuar të arrijnë marrëveshje politike për çështjen e zgjedhjes së presidentit.

Kryeministri në detyrë dhe lideri i LV-së, Albin Kurti është takuar për herë të katërt me kryetarin e LDK-së, Lumir Abdixhiku, të premten, por të dy kanë thënë se dallimet në qëndrime dhe kërkesa mes tyre janë të thella, gjë që e bënë shumë të zorshme arritjen e një marrëveshjeje politike. Mospajtimi kryesor mes tyre është posti i presidentit, të cilin e do me ngulm LDK-ja. Duke folur pas takimit, Kurti ka thënë se “nuk kemi ende marrëveshje politike”.

“Pritjet janë të ndryshme, qëndrimet nuk përputhen dhe është bindja ime që ka një dallim drastik midis rezultatit

zgjedhor dhe kërkesave të LDK-së”, ka thënë Kurti.

Duke folur për kërkesën e LDK-së, e cila ka siguruar 18 vende në Kuvend, për postin e presidentit, Kurti ka nënvizuar se “si LV nuk mund të bëjmë marrëveshje që do ta zëvendësonte vullnetin e popullit dhe do ta deformonte rezultatit zgjedhor”.

“Në marrëveshje politike duhet ta pasqyrojnë raportin e vendeve që i kemi në Kuvend”, ka thënë Kurti.

Ndërsa kryetari i LDK-së, Lumir Abdixhiku, ka thënë se ka kërkuar që partia që drejton ta propozojë emrin e presidentit, por “në këtë pikë nuk kemi pasuar pajtueshmëri”. Abdixhiku ka paralajmëruar se partia e tij nuk ka vullnet për vazhdimin e bisedimeve, nëse nuk i jepet mundësia ta propozojë kandidatin për president.

“Përfaqësimi i vetëm që mund të mbetet është një përfaqësim nga LDK-ja, një emër që e bisedojmë bashkërisht me LVV-në. Nëse kjo nuk mund të arrihet, atëherë me keqardhje them se LDK-ja nuk mund të kontribuojë më tepër për bisedime e takime”, ka thënë ai. Abdixhiku ka thënë se oferta e deritanishme që LDK-ja ta ketë postin e kryetarit të Kuvendit, atë të zëvendëskryeministrit dhe disa ministri, “nuk është e mjaftueshme për të dhënë zgjidhje”. Por, Kurti ka ngulur këmbë se ai është i interesuar të bashkëqeverisë me LDK-në dhe “ata t'i kenë postet e tyre, prej postit të zëvendëskryeministrit dhe disa ministrave”.

Takimi mes tyre është zhvilluar disa orë para se të përfundojë afati kushtetues për konstituimin e Kuvendit të Kosovës. Të enjten, Kurti ka

kërkuar nga kryesuesi Avni Dehari, për të shtyrë seancën konstituive të Kuvendit, duke kërkuar kohë shtesë për një marrëveshje politike që do të jepte një zgjidhje për çështjen e presidentit.

Por, Abdixhiku ka thënë se duhet të ketë seancë konstituive dhe Kosova të ketë kryeparlamentar dhe nënkryetarë Kuvendi brenda afatit kushtetues. Dy partitë e tjera, PDK-ja dhe Aleanca nuk kanë pranuar të hyjnë në negociata me Kurtin, duke shprehur qëndrimin se duan të jenë në opozitë. Më herët gjatë ditës së premte, kreu i PDK-së, Bedri Hamza, përmes një shkrese, ka refuzuar sërish takimin me Kurtin. Ai i është përgjigjur pozitivisht vetëm ftesës së parë të Kurtit dhe pas takimit të tyre më 10 korrik, Hamza deklaroi se partia e tij do të mbetet në opozitë.

Aleanca, ndërkaq, ka refuzuar të gjitha ftesat për takim, duke argumentuar se veçse ka paraqitur disa pika për LV-në, të cilat nëse përmbushen, Kurti do të ketë shtatë votat e Aleancës për formimin e institucioneve. Pas shtyrjes së seancës konstituive më 6 gusht, organizatat joqeveritare në Kosovë bënë thirrje për respektimin e afatit kushtetues për formimin e institucioneve, teksa mirëpritën bisedimet për arritjen e një marrëveshjeje politike. Ndërkaq, ambasadat e akredituara në Kosovë bënë thirrje që Kosova sa më shpejt të ketë institucione me mandat të plotë, në mënyrë që të vazhdohet me agjendën e reformave evropiane. Nëse partitë nuk arrijnë një ujdj për krijimin e institucioneve, atëherë vendi rrezikon të mbajë zgjedhje të reja – që do të ishin të katërtat në gati dy vjet.



lindur nga një domosdoshmëri absolute për të parandaluar shkatërrimin e plotë të popullit shqiptar. Barazimi i veprimeve të një populli të kolonizuar dhe të sulmuar, i cili luftonte për mbijetesë, me aparatit shtetëror të terrorit të Serbisë përbën një dështim moral. Jeta e rreth 15 mijë civilëve shqiptarë të vrarë, vuajtjet e rreth 25 mijë viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës dhe zhvendosja e më shumë se një milion refugjatëve – shifra që ende nuk pasqyrohen plotësisht në të dhënat zyrtare – nuk duhet të harrohen. Mbi të gjitha, dhimbja e jashtëzakonshme e një populli nuk mund të njolloset duke kriminalizuar udhëheqësit që u ngritën për ta ndaluar një gjenocid.

Lidhja e pathyeshme me Shtetet e Bashkuara

Kosova është krenare që konsiderohet ndër kombet më pro-amerikane në botë. Liria e saj u ndërtua mbi një lidhje të fuqishme me Shtetet e

Bashkuara, e vulosur nga ndërhyrja historike e ushtrisë amerikane në vitin 1999. Përgjatë administratave të presidentëve George H. W. Bush, Bill Clinton dhe George W. Bush, si dhe gjatë mandateve tuaja, udhëheqësit e Kosovës kanë qëndruar krah për krah me Uashingtonin në çështjet kryesore të sigurisë globale. Në të kundërt, proceset aktuale në Hagë rrezikojnë të dëmtojnë këtë trashëgimi. Ato largojnë një partner të përkushtuar strategjik në një rajon të paqëndrueshëm dhe dërgojnë mesazhin se edhe aleatët më të afërt të Amerikës mund të braktisen përballë mekanizmave gjyqësorë ndërkombëtarë që nuk përputhen me parimet amerikane të drejtësisë dhe sovranitetit.

Trashëgimia juaj në mbrojtje të Kosovës kundër agresionit

Zoti president, administrata juaj ka dështuar një kuptim të

thellë të dinamikave të Ballkanit. Ju tejkaluat qasje të vjetra diplomatike dhe kontribuat në arritjen historike të Marrëveshjes së Uashingtonit në vitin 2020, duke u fokusuar në normalizimin ekonomik dhe duke siguruar njohjen e Kosovës nga Izraeli.

Ju keni mbështetur vazhdimisht mbrojtjen e Kosovës nga agresioni i ri serb dhe politikat revanshiste. Sot, Beogradi dhe aleatët e tij në Moskë po e përdorin aktivisht procesin në Hagë si një mjet propagandistik për të rehabilituar regjimin e Millosheviqit, për të delegjitimuar shtetësinë e Kosovës dhe për të dobësuar ndikimin amerikan në Evropën Juglindore.

Çmontimi i këtij narrativi politik rreth tribunalit është një vazhdim i natyrshëm i politikës suaj për kundërshtimin e ndikimit të dëmshëm të huaj dhe garantimin e një paqeje të qëndrueshme e dinjitoze. Sigurimi i paqes kërkon përfundimin e menjëhershëm të

këtyre proceseve politike dhe lirim të shpejtë të Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit, duke u mundësuar atyre kthimin në atdheun e lirë.

Rruga përpara -Aktet e mbrojtjes nuk përbëjnë krime lufte

Zoti president,

Ndërsa Dhomat e Specializuara të Kosovës në Hagë po i afrohen vendimeve përfundimtare në fund të shtatorit 2026, Shtetet e Bashkuara nuk mund të qëndrojnë indiferente. Dhomat e Specializuara të Kosovës kanë devijuar nga misioni i tyre fillestar. Ato janë shndërruar në një mekanizëm jo transparent, i cili në mënyrë joproporcionale ka vënë në shënjestër viktimat e konfliktit, ndërsa ka lënë në hije përgjegjësit kryesorë të luftës. Në mënyrë të ngjashme, argumenti i Sekretarit amerikan të Shtetit, Marco Rubio, kundër veprimeve të Gjykatës Penale

Ndërkombëtare bazohet në shqetësimin se tribunalet e huaja mund të ndjekin penalisht individë për mbrojtjen e vendit të tyre. Në rastin e UÇK-së, proceset në Hagë po i interpretojnë gabimisht konfliktet lokale të mbrojtjes si krime lufte.

Zoti president, ju bëjmë thirrje urgjente që të përdorni fuqinë diplomatike amerikane për të rishikuar mandatin e këtij tribunali, për t'i dhënë fund tejkalimit të pafund juridik dhe për t'i dëshmuar botës se mbrojtja e atdheut kundër gjenocidit nuk është kurrë krim. Ju falënderojmë për përkushtimin tuaj të vazhdueshëm ndaj drejtësisë, forcën tuaj në skenën ndërkombëtare dhe miqësinë tuaj të vazhdueshme me popullin e Kosovës.

**Me respektin dhe konsideratën më të lartë,
Dr. Elmi Berisha
President i Federatës Pan-Shqiptare të Amerikës VATRA**

Dorëheqjet e gjyqtarëve serbë, dështon sërish mbledhja e KGjK-së

PRISHTINË, 7 GUSHT - Sërish ka dështuar mbledhja e Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGjK), pasi edhe të premtën mungoi kuorumi i nevojshëm për zhvillimin e saj. Në rend të ditës ishte paraparë shqyrtimi i kërkesës së ushtrueses së detyrës së presidentes së Republikës së Kosovës, si dhe njoftimeve të gjyqtarëve dhe stafit

administrativ nga komuniteti serb për tërheqjen e dorëheqjeve. Pas fillimit të mbledhjes, kryesuesi i KGjK-së, Rrustem Thaqi, ka bërë të ditur se disa prej anëtarëve kanë njoftuar për arsyet e mungesës, ndërsa disa të tjerë jo. Duke kritikuar mungesën e tyre, Thaqi ka theksuar se për shkak të mungesës së kuorumit mbledhja nuk mund të mbahet. “Më kanë

informuar se katër prej tyre nuk do të marrin pjesë në takim... Asnjë nga anëtarët nuk kanë paraqitur kërkesë për pushim. Nuk mund të lejohet sjellja e tillë. Si pasojë e mungesës së kuorumit ky takim nuk mund të mbahet”, ka thënë ai. Kjo është hera e dytë që KGjK-ja dështon ta mbajë mbledhjen për shkak të mungesës së kuorumit.



GJERMANIA IA EKSTRADON KOSOVËS TË DYSHUARIN E SHUMËKËRKUAR PËR VJEDHJE TË RËNDË



PRISHTINË, 7 GUSHT - Policia e Kosovës, përkatësisht Drejtoria për Bashkëpunim Ndërkombëtar Policor, në koordinim dhe bashkëpunim me njësitë tjera relevante të Policisë së Kosovës dhe institucionet e drejtësisë, ka realizuar të premtën ekstradimin e një shtetasi kosovar nga Gjermania në

Kosovë. I dyshuari ishte arrestuar nga autoritetet gjermane, pasi ishte kërkuar përmes Interpolit me letër-arrestim ndërkombëtar të lëshuar nga institucionet e drejtësisë së Kosovës, për veprën penale “Vjedhje e rëndë”. Ekstradimi është realizuar në bazë të ligjeve në fuqi dhe bashkëpunimit të ngushtë

ndërmjet institucioneve të Republikës së Kosovës dhe atyre të Gjermanisë. Pas ekstradimit, i dyshuari iu është dorëzuar njërive përkatëse të Policisë së Kosovës për vazhdimin e procedurave të mëtejshme ligjore. Policia e Kosovës, përmes Drejtorisë për Bashkëpunim Ndërkombëtar Policor, ka bërë të ditur se do të

vazhdojë shkëmbimin e informacioneve me institucionet vendore, shtetet dhe organizatat ndërkombëtare, me qëllim të parandalimit, hetimit dhe zbulimit të aktiviteteve kriminale, si dhe gjurmimit, kapjes dhe arrestimit të personave dhe grupeve kriminale që veprojnë brenda dhe jashtë vendit.

HARADINAJ PËRKUJTON DËSHMORËT E FAMILJES MARKALLESHI

GJAKOVË, 7 GUSHT - Ish-kryetari i Aleancës dhe ish-komandanti i UÇK-së në Dukagjin, Ramush Haradinaj, ka përkujtuar familjen Markallesi nga Vraniqi i Gjakovës, duke vlerësuar sakrificën e saj në luftën për lirinë e Kosovës. Në një postim në “Facebook”, Haradinaj ka theksuar se familja Markallesi ka qëndruar e patrembur përballë çdo armiku dhe ishte gjithmonë në ballë të betejave për çlirimin e atdheut. Ai ka kujtuar se kjo familje i ka dhënë Kosovës katër dëshmorë, Markun, Kolën,

Prendin dhe Memën, duke veçuar 7 gushtin 1998 si ditën kur, në përballje me forcat armike, ranë heroikisht Mark dhe Kolë Lleshi, ndërsa idealin e tyre e vazhduan Prendi dhe Mema. Haradinaj ka përmendur gjithashtu kontributin e Gegës, Tomës dhe Nikës, të cilët, sipas tij, qëndruan në vijën e parë të shumë betejave të luftës çlirimtare dhe nuk u tërhoqën asnjëherë nga rruga e tyre. “Lavdi e përjetshme dëshmorëve të familjes Markallesi!”, ka shkruar Haradinaj.



SISTEMI I KAMERAVE NË PRISHTINË KA EVIDENTUAR RRETH 4 400 SHKELJE NË TRAFIK



PRISHTINË, 7 GUSHT - Kryetari i Prishtinës, Përparim Rama, ka bërë me dije së bashku me Policinë e Kryeqytetit kanë shqyrtuar rezultatet e fazës së parë të sistemit të kamerave të sigurisë dhe kanë diskutuar për

zgjerimin e mëtejshëm të tij. Sipas Ramës, aktualisht sistemi përfshin 55 lokacione, 165 kamera aktive, 40 kamera ANPR për njohjen automatike të targave, si dhe monitorim 24 orë në ditë.

Ai ka treguar se nga janari deri në fund të korrikut janë evidentuar dhe shqiptuar rreth 4 400 gjopa për shkelje në trafik. Rama ka njoftuar se faza e dytë do të përfshijë zgjerimin e rrjetit të kamerave, vendosjen e radarëve

në zona kritike, përdorimin e video-analitikës dhe teknologjive më të avancuara. “Bashkë me Policinë e Kosovës po ndërtojmë një Kryeqytet më të sigurt, me më shumë rend dhe siguri për secilin qytetar”, ka njoftuar Rama.

Përurohet QMF-ja e re në Gurrakoc të Istogut

ISTOG, 7 GUSHT - Është përuar zyrtarisht Qendra e Mjekësisë Familjare (QMF) në Gurrakoc, një investim i rëndësishëm për përmirësimin e shërbimeve shëndetësore dhe krijimin e kushteve më të mira për qytetarët e kësaj ane.

Në ceremoninë e përuimit, prerjen e shiritit e kanë bërë kryetari i Komunës së Istogut, Ilir Ferati, drejtori i Shëndetësisë, Fisnik Shoshaj, si dhe kreu i Bashkësisë Islame të Kosovës, myftiu Naim Tërnavë. Ky projekt është realizuar falë

donacionit nga Shteti i Kuvajtit, me ndërmjetësimin dhe angazhimin e Bashkësisë Islame të Kosovës, e cila ka kontribuar në krijimin e mundësive për ndërtimin dhe funksionalizimin e kësaj qendre mjekësore.



LIDHJET E LËVIZJES RUSE TË EKSTREMIT TË DJATHTË ME BALLKANIN

PRISHTINË, 6 GUSHT - Një këshilltar nga radhët e partisë në pushtet në Vishegrad, në lindje të Bosnjë e Hercegovinës, ka promovuar organizatën ultranacionaliste ruse Rusov, anëtarët e së cilës marrin pjesë në agresionin rus kundër Ukrainës. Siç ka raportuar më herët “Radio Evropa e Lirë (REL)”, Lëvizja Ndërkombëtare Bashkimi dhe Ringjallja Ruso-Sllave (Rusov) mban kontakte me disa grupe të ekstremit të djathtë nga Serbia, ndërsa lideri i kësaj lëvizjeje, Andrei Rodionov, ka vizituar disa herë vendet e rajonit. Në kanalën e këtij grupi në “Telegram”, në prill është publikuar një fotografi ku shihet Velibor Zekoviq, këshilltar i Partisë Socialiste të Republikës Sërpska në Kuvendin e Vishegradit, duke pozuar me flamurin e Rusovit në kodrën Zagllavak, pranë Vishegradit.

Në shoqërinë e tij është edhe Zhellko Gjuroviq, i cili rreth dhjetë vjet më parë prezantohej si shef i degës serbe të Lëvizjes Gjithë-Ruse Fronti i Kosovës, të cilën autoritetet ukrainase e kanë cilësuar si një entitet që organizon dërgimin e njerëzve nga Ballkani në frontin e luftës në Ukrainë. Gjuroviq ka po ashtu në mëngën e xhakës një emblemë me simbolin e Rusovit.

Në përshkrimin e fotografisë thuhet se Zekoviq dhe Gjuroviq janë “aleatë serbë të lëvizjes Rusov” dhe se ndodhen “te vendi ku në vitin 1993 vullnetarët rusë luftuan dhe derdhën gjak krah për krah me serbët për Bosnjën serbe”. Velibor Zekoviq nuk iu përgjigj telefonatave dhe mesazheve të “Radio Evropa e Lirë” për të folur rreth lidhjeve të tij me lëvizjen Rusov. As nga Partia Socialiste e Republikës Sërpska nuk ka ardhur ndonjë koment për fotografinë.

“REL”-i i ka shkruar edhe Zhellko Gjuroviqit përmes rrjetit rus Vkontakte dhe postës elektronike, por ai nuk ka kthyer përgjigje. Përgjigje nuk ka ardhur as nga lëvizja Rusov.

Lidhjet e politikës së Bosnjës me të djathtën ruse

“Është paradoksale që partitë që nominalisht quhen socialiste flirtojnë me organizata të krahut të djathtë dhe nuk kanë asnjë lidhje me ideologjinë e së majtës”, ka vlerësuar për “Radion Evropa e Lirë (REL)” Gjorgje Vujatoviq, gazetar nga Banjalluka që ndjek temat që lidhen me ndikimet e huaja në Bosnjë e Hercegovinë. Megjithatë, ai ka theksuar se kontaktet e aktorëve politikë nga entiteti i Republikës Sërpska me grupet e djathta ruse nuk janë përjashtim, por një praktikë e vazhdueshme. “Në të kaluarën kemi pasur raste kur shumë zyrtarë dhe funksionarë të lartë kanë marrë

pjesë në ngjarje ku ka qenë i pranishëm edhe Aleksandër Zaldostanov, i njohur me nofkën ‘Kirurgu’, lideri i grupit rus të motoçiklistëve ‘Ujqërit e Natës’, i cili është në listën e zezë të Shteteve të Bashkuara. E gjithë politika kryesore është e lidhur me Federatën Ruse”, ka thënë Vujatoviq.

Arsyet e afrimit të partive kryesore nga Republika Sërpska me Rusinë, Vujatoviqi i sheh para së gjithash te oportunitizmi politik. Ai ka theksuar se opinioni publik në këtë entitet është në masë të madhe i prirë ndaj narrativit rus dhe politikës së presidentit rus, Vladimir Putin. “Aktorët politikë e kanë kuptuar se kjo është e leverdishme për të ardhur në pushtet dhe të gjithë po hyjnë në valën e këtij populizmi dhe po luajnë me kartën e lidhjeve historike me Rusinë, pansllavizmit dhe ortodoksisë si faktor bashkimi”, është shprehur ai.

Nga ana tjetër, sipas tij, për organizatat ruse është e rëndësishme që idetë e tyre t’i përhapin përtej kufijve të Rusisë. “Ballkani, për shkak të lidhjeve historike, është hapësira më e përshtatshme për këtë veprimtari përmes përfaqësuesve dhe për shfaqjen e përkatësisë ndaj botës shumëpolare, siç e quajmë ata”, ka konsideruar Vujatoviq.

Lidhjet e luftës ruso-serbe

Zekoviqi dhe Gjuroviq kanë shpalosur flamurin e organizatës ruse pas një kryqi të improvizuar, të bërë nga kontejnerë bosh të granatahdhësve, në një vend ku gjatë luftës në Bosnjë e Hercegovinë në vitet ’90 vepronin pjesëtarë të Ushtrisë së Republikës Sërpska dhe vullnetarë nga Rusia. Prej vitesh, shoqatat e veteranëve të luftës nga Republika Sërpska organizojnë shënimin e “Ditës së Vullnetarëve Rusë”. Ndryshe nga vitet e mëparshme, këtë vit autoritetet e Bosnjë e Hercegovinës ua ndaluan vullnetarëve rusë hyrjen në territorin e vendit, ndaj në shënim morën pjesë përfaqësues të shoqatave të veteranëve të entitetit dhe familjarë të vullnetarëve nga



Federata Ruse. Ndër personat të cilëve iu ndalua hyrja në Bosnjë ishte edhe Aleksandër Kravçenko, ish-vullnetar rus në Bosnjë dhe themelues i organizatës Fronti i Kosovës, me të cilën është i lidhur edhe Zhellko Gjuroviq. Organizata e tij ishte aktive edhe para fillimit të pushtimit të plotë të Ukrainës, gjatë konfliktit në lindje të këtij vendi, në rajonin e Donbasit.

Autoritetet ukrainase e kanë cilësuar Frontin e Kosovës si organizatë që luan rol në rekrutimin e vullnetarëve nga Ballkani, por Kravçenko e ka mohuar këtë në një intervistë të mëhershme për “REL”-in. Në kontekstin e shtetasve që shkojnë si vullnetarë në frontin e luftës në Ukrainë, Gjorgje Vujatoviq ka vlerësuar se kontaktet mes aktorëve rusë dhe serbë nuk paraqesin kërcënim të drejtpërdrejtë për sigurinë e brendshme të Bosnjë e Hercegovinës. Megjithatë, ai ka theksuar se problemi qëndron te fakti se shteti rrallë i sanksionon shtetasit që marrin pjesë në luftëra të huaja. “Shkuarja në fronte të huaja është e dënueshme, por shteti nuk reagon, pjesërisht edhe për shkak se disa prej këtyre njerëzve kanë marrë shtetësi ruse”, ka thënë Vujatoviq.

Lidhjet ruso-serbe kanë mbetur aktive edhe pasi Kremli nisi pushtimin ushtarak të Ukrainës në shkurt të vitit 2022. Numri i saktë i shtetasve të Bosnjës që kanë shkuar si mercenarë në frontin e luftës në Ukrainë nuk dihet, por Europoli ka njoftuar në vitin 2025 se në mesin e qindra pjesëtarëve të identifikuar të grupeve ruse të

mercenarëve Wagner dhe Redut ka edhe shtetas të Bosnjë e Hercegovinës.

Një nga figurat më të njohura është Davor Savić, një serb i Bosnjës, i cili mban gradën e kolonelit në Drejtorinë Kryesore të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Federatës Ruse, të njohur si GRU. Autoritetet ukrainase kanë nisur procedurë penale ndaj tij për krime lufte. Në fillim të vitit 2023, në “Telegram” është publikuar një video e dy ushtarëve të maskuar, të cilët në gjuhën serbe kanë thënë se i ishin bashkuar forcave ruse në Ukrainë, më saktësisht batalionit Sudoplatov.

Të prezantuar me emrat e koduar “Danubi” dhe “Sava”, ata e kanë përshkruar veten si “patriotë serbë dhe rusofilë” që kishin ardhur për t’u ndihmuar “vëllezërve rusë”.

Identiteti i tyre nuk është përcaktuar zyrtarisht, por mediat në Bosnjë e Hercegovinë kanë zbuluar se bëhet fjalë për shtetas të këtij vendi, ndaj të cilëve është lëshuar fletarrestim nga Interpoli për vepra penale. Në videon ku flisnin “Danubi” dhe “Sava”, ata mbanin emblemën e lëvizjes Rusov. Simboli i skifterit të verdhë me kryqin diellor, i përhapur në ikonografinë e grupeve të ekstremit të djathtë, shihet edhe në flamurin që në prill të vitit 2026 e kanë shpalosur Velibor Zekoviqi dhe Zhellko Gjuroviq.

Çfarë është lëvizja Rusov?

Bëhet fjalë për simbolin e një shoqate ruse, e cila në manifestin e saj zyrtar rendit si një nga qëllimet themelore rikthimin e “Rusisë së Madhe historike, mbrojtëses së sllavëve, bastionit të vlerave tradicionale dhe garantueses së ndërtimit të një shoqërie të drejtë nga pikëpamja sociale”. Lëvizja Rusov ka mbështetur separatistët proruse pas shpërthimit të konfliktit në lindje të Ukrainës në vitin 2014. Rodionovi, sipas pretendimeve të tij, ka themeluar njësinë Feniks, e cila ka luftuar në kuadër të brigadës Prizrak, ku kanë qenë edhe disa vullnetarë nga Serbia. Në një fotografi, për të cilën pretendohet se është bërë në

vitin 2015 në territorin e të ashtuquajturës “Republikë Popullore e Luhanskut”, shihet Rodionovi me uniformë kamuflazhi duke mbajtur, së bashku me një person tjetër, një flamur të kuq me simbolin e ekstremit të djathtë, të njohur edhe si “svastika sllave”.

Pas fillimit të pushtimit rus, Rodionovi ka publikuar në Telegram fotografi të tij me uniformë dhe armë, duke pretenduar se në vitin 2023 iu bashkua Korpusit Vullnetar Sullmues të Federatës Ruse.

Rusov dhe Ballkani

Kjo lëvizje është themeluar në vitin 2012, ndërsa themeluesi i saj, Andrej Rodionov, ka qëndruar disa herë në Ballkan, gjë që e ka dokumentuar edhe me fotografi në rrjetet sociale. Në një intervistë për Radio Beogradin në vitin 2020, ai ka thënë se në lëvizjen e tij anëtarësohen “jo vetëm organizata dhe lëvizje të tjera, por edhe parti”.

Mediat në Maqedoninë e Veriut kanë raportuar se Rodionovi e ka vizituar këtë vend disa herë që nga viti 2017, ndërsa në afërsi të Shkupit, në vitin 2018, ka organizuar një kamp për mësimin e arteve marcialë dhe të “traditave shpirtërore të Rusisë së Lashtë”. Në Serbi, Rodionovi mban kontakte me grupin e paregjistruar të ekstremit të djathtë Patrulla Popullore, i njohur për aksionet kundër migrantëve. Me liderin e këtij grupi, Damnjan Knezheviq, Rodionovi ka shënuar në Beograd, në vitin 2021, 100-vjetorin e eksodit të monarkistëve rusë nga Rusia pas Revolucionit të Tetorit.

Ndërkohë, Rusov është lidhur me grupin Skifteri Serb, një grup më pak i njohur i ekstremit të djathtë, i cili në korrik të vitit 2024 ka organizuar në Novi Sad një tubim kushtuar “çlirimit të Srebrenicës”, duke iu referuar përvjetorit të gjenocidit të kryer nga forcat e Republikës Sërpska nën komandën e Ratko Mlladiqit në vitin 1995.

Mlladiqi është dënuar me burgim të përjetshëm nga Tribunali Ndërkombëtar në Hagë për këtë dhe krime të tjera në Bosnjë e Hercegovinë.

Në një fotografi të publikuar në maj të vitit 2025 në profilin e grupit Skifteri Serb në Instagram, shihet Andrej Rodionovi duke pozuar me tre persona të maskuar, me uniforma dhe armë, ndërsa janë shpalosur flamujt e Rusovit dhe Skifterit Serb.

Në përshkrimin e fotografisë shkruhet: “Bashkëlloftëtarët rusë me skifterët serbë në frontin e mbrojtjes së ortodoksisë”, ndërsa si lokacion është shënuar Donjecku, në lindje të Ukrainës. Flamuj me simbolet e lëvizjes Rusov janë valëvitur edhe gjatë protestave në mbështetje të pushtimit rus të Ukrainës, të organizuara në disa raste nga grupet e ekstremit të djathtë në Beograd.



PENSIONISTËT E KOSOVËS: PENSIONET NUK PO MJAFTOJNË PËR SHPENZIMET BAZË

PRISHTINË, 7 GUSHT - Rritja e çmimeve dhe kostos së jetesës po e vështirëson gjithnjë e më shumë gjendjen e pensionistëve në Kosovë, të cilët kanë thënë se pensionet aktuale nuk u mjaftojnë për të mbuluar shpenzimet bazë mujore. Shumë prej tyre kanë theksuar se pa ndihmën e familjarëve do ta kishin të pamundur ta përballonin jetën e përditshme, ndërsa kërkojnë nga institucionet që të rishikojnë nivelin e pensioneve dhe t'i kushtojnë më shumë vëmendje kësaj kategorie.

Ramadan Bllaca, pensionist dhe veteran i arsimit, ka thënë se pensionet janë të ulëta dhe se ato nuk janë rritur prej kohësh. “Me pensionet nuk jam veç unë, po nuk janë asnjëri të kënaqur, se pensionet vërtetë janë shumë të ulëta dhe nuk janë rritur kaherë”, ka thënë ai. Bllaca ka treguar se pa ndihmën e fëmijëve do ta kishte të vështirë ta përballonte muajin. “Vallahi, me qenë veç si individ unë, se unë jam veteran i arsimit, kam punuar para luftës, i marrim nja 100 euro

shtesë, pak e kemi pension më të madh se të tjerët, po si individ s’e di a kisha mundur me ia dalë a jo, por më ndihmojnë fëmijët”, është shprehur ai.

Ai ka kërkuar që shteti t’i ketë parasysh pensionistët, pasi shumë prej tyre nuk arrijnë t’i mbulojnë shpenzimet mujore. “Pensionet, kjo kategori e pensionistëve që janë, duhet me hy nën kontrollin e shtetit edhe me i pasur parasysh, se nuk kanë kah jetojnë. Po nuk po flas veç për vete, se unë thashë se më ndihmojnë fëmijët, po ndiej se ka shumë pensionistë të cilët nuk mundën ta mbulojnë kursesi muajin”, ka thënë ai.

Pavarësisht pakënaqësive, Bllaca ka shprehur shpresën se gjendja mund të përmirësohet, duke theksuar se ndihma duhet t’u ofrohet edhe kategorive të tjera në nevojë. “Po, njeriu jeton me shpresa dhe ne shpresojmë që ndoshta nesër, pas nesër do të bëhet më mirë. Ne nuk kërkojmë më shumë se të tjerët, se ne jemi shtetformues dhe jemi në formim e sipër. Nuk duam ne diçka më tepër, por duhet pak me i shikuar



edhe kategoritë e tjera, mos me shiku me marrë sa më shumë, por me u kënaqur edhe me më pak, që edhe kategoritë e tjera të marrin. Se nuk janë veç pensionistët, por janë edhe shumë familje me ndihmë sociale që kanë nevojë për ndihma shtetërore”, ka deklaruar ai për “Ekonomia Online”.

Ndërsa pensionisti Bedriu ka thënë se nuk është i kënaqur me gjendjen aktuale, duke

theksuar se rritja e çmimeve ka ndikuar edhe te pensionistët. “Po jo bre. Të gjithë e dinë se, për shembull, këtu u bë shtrenjtim si në Evropë. Të gjitha gjërat i ke më shtrenjtë. Me 47 vjet stazh i merr 240 euro. Ne kemi kontribuar për Buro Ramizin 10 vite. Asnjë pensionist një cent nuk fitojmë prej aty”, ka thënë ai.

Megjithatë, ai ka shtuar se pensioni i mjafton për disa shpenz-

ime. “Po diçka po. Po, shpresojmë. Por ka shumë që marrin pa nevojë”, është shprehur ai.

Kurse pensionisti tjetër, Tahir Syla, ka thënë se nuk e merr pensionin e pleqërisë, por atë të veteranit, i cili, sipas tij, nuk është i mjaftueshëm. “Unë e marr pensionin e veteranëve, e ajo nuk po na mjafton, po më duket se tash e kanë bërë të mundshme me e marrë edhe pensionin e pleqërisë. E këtu dihet diçka munden me bë, se jo madje veç këto që janë duke i rregulluar, nuk e di sa, se jo me 200 euro”, ka thënë ai.

Syla ka treguar se për blerjen e duhanit dhe barnave, pensioni nuk i mjafton. “Me pi duhanin e barna, jo, jo valla”, është shprehur ai.

Ai nuk ka shprehur shumë shpresë për përmirësimin e gjendjes së pensionistëve, duke përmendur edhe mungesën e institucioneve të reja. “Vallahi, njëherë për njëherë s’po mendojmë. S’ka përmirësim, çfarë hallakame atje, s’është askund, qeveria s’është në nivel, s’është as populli, as askush”, ka thënë Syla.

MINTI DHE AUV-I NISIN VERIFIKIMIN E PRODUKTEVE TË QUMËSHTIT NË MBARË VENDIN

Prishtinë, 7 gusht - Pas raportit të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV) mbi gjetjet laboratorike të mostrave të analizuar nga produktet e qumështit, Inspektorati Qendror për Mbikëqyrjen e Tregut (IQMT), në bashkëpunim me inspektorët e AUV-së, ka nisur sot një aksion të koordinuar për inspektimin e deklaracioneve dhe etiketimit të produkteve të qumështit në rrjetet e marketeve në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës.

Me qëllim të mbrojtjes së konsumatorëve, garantimit të informimit të saktë për produktet ushqimore dhe forcimit të sigurisë në treg, Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit (MINTI) do të intensifikojë mbikëqyrjen e tregut të produkteve të



qumështit, duke përfshirë si produktet e prodhuara në Kosovë, ashtu edhe ato të importuara.

Në përputhje me Ligjin për Ushqimin dhe Ligjin për Mbrojtjen e Konsumatorit, inspektimet janë fokusuar në verifikimin e etiketimit, reklamimit dhe paraqitjes së produkteve në treg, për të

vlerësuar nëse ato janë në përputhje me rezultatet e ekzaminimeve laboratorike të kryera nga AUV-ja.

Për të parandaluar praktikatat mashtruese ndaj konsumatorëve, MINTI u ka bërë thirrje të gjitha kompanive, produktet e të cilave kanë rezultuar se nuk janë në përputhje me deklaracionin e

vendosur në etiketë, që të ndërmarrin menjëherë masat e nevojshme për korrigjimin e etiketimit dhe tërheqjen e produkteve nga tregu.

Në të kundërtën, në bazë të kompetencave ligjore, IQMT-ja dhe AUV-ja do të ndërmarrin masa administrative dhe ndëshkuese, përfshirë edhe ndalimin e përkohshëm të tregtimit të produkteve që nuk i përmbushin kërkesat ligjore.

Gjithashtu, lidhur me dyshimet për përdorimin e ujit të ujitjes në procesin e prodhimit dhe përpunimit të produkteve të qumështit nga një kompani në Kosovë, IQMT-ja ka zhvilluar sot një inspektim për vlerësimin e përmbushjes së kushteve minimale teknike, në bashkëpunim me zyrtarët e Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) dhe zyrtarët e

Kompanisë Rajonale të Ujësllësit “Drini i Bardhë” në Pejë.

Gjatë inspektimit janë marrë mostra të ujit që përdoret në procesin e prodhimit, të cilat do t’i nënshtrohen analizave laboratorike fiziko-kimike, mikrobiologjike dhe analizave për praninë e metaleve.

Pas përfundimit të analizave dhe pranimit të rezultateve zyrtare, institucionet kompetente do të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme në përputhje me legjislacionin në fuqi.

MINTI ka bërë me dije se mbetet e përkushtuar në mbrojtjen e interesit të konsumatorëve, garantimin e konkurrencës së ndershme në treg dhe zbatimin e plotë të standardeve ligjore për sigurinë dhe cilësinë e produkteve ushqimore.

ASK-ja: Rritet numri i vizitorëve në hotelet e Kosovës gjatë muajit qershor

PRISHTINË, 7 GUSHT - Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka publikuar statistikatat e hotelerisë për muajin qershor 2026. Sipas njoftimit të ASK-së, numri i vizitorëve në hotelet e Kosovës ka shënuar rritje gjatë muajit qershor 2026, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Nga të dhënat zyrtare është bërë me dije se gjatë këtij

muaji në hotelet e Kosovës janë regjistruar gjithsej 70 234 vizitorë. Prej tyre, 28 638 ishin vizitorë vendorë, ndërsa 41 596 ishin vizitorë të huaj.

Krahasuar me qershorin e vitit 2025, kur numri i përgjithshëm i vizitorëve ishte 63 502, në qershor të këtij viti është shënuar rritje prej 10.6 për qind. “Në qershor 2026, numri i

vizitorëve në hotele ishte 70 234, prej tyre vizitorë vendorë ishin 28 638 dhe vizitorë të jashtëm ishin 41 596. Krahasuar me muajin qershor të vitit 2025, kur ishin 63 502 vizitorë, pati rritje të numrit të përgjithshëm të vizitorëve në hotele për 10.6 për qind”, është thënë në njoftimin e ASK-së.

Ndërsa numri i net-

qëndrimeve gjatë këtij muaji ishte 163 739. Prej tyre, 85 783 net-qëndrime, ose 52. 4 për qind, u realizuan nga vizitorët e jashtëm, ndërsa 77 956, ose 47.6 për qind, nga vizitorët vendorë.

Sa u përket vizitorëve të huaj, në muajin qershor 2026, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit paraprak, është



shënuar rritje prej 5.2 për qind. “Në total, 41 596 vizitorë të huaj, nga të cilët numri më i madh ishte nga Shqipëria, Gjermania, Turqia, Zvicra, etj.”, është thënë në njoftimin e ASK-së.

SI PO NDIHMON TEKNOLOGJIA NË LUFTËN KUNDËR ZJARREVE NË PYJE



Pamjet janë të njohura dhe tronditëse: zjarre të fuqishme që përballohen nga zjarrfikësit dhe avionë që hedhin ujë mbi flakët.

Qindra mijëra njerëz janë detyruar të largohen nga shtëpitë e tyre në Francë, Spanjë dhe Portugali, ndërsa zjarret masive kanë përfshirë pyje dhe zona rurale.

Por pse ende përdoren njerëzit dhe avionë 30-vjeçarë? Pse dronët mund të zëvendësojnë ushtarët në Ukrainë, por jo zjarrfikësit?

Shefi i togës, Guillaume Millet, zjarrfikës me 24 vite përvojë dhe drejtues i degës së Shërbimit të Zjarrfikjes dhe Shpëtimit në sindikatën CFDT në Gironde, zonën më të prekur nga zjarret në Francë këtë verë, thotë se mënyrat e shuarjes së zjarreve nuk kanë ndryshuar shumë, por teknologjia për zbulimin e tyre ka bërë hapa të mëdhenj.

“Ndryshimi i madh, veçanërisht në departamentin tim, është se tani kemi kamera të asistuar nga inteligjenca artificiale, të cilat monitorojnë pyjet dhe zbulojnë se ku po nisin zjarret”, thotë Millet.

Në Gironde, këto kamera kanë zëvendësuar vrojtuesit njerëzorë që qëndronin në kullat e vëzhgimit gjatë muajve të verës. Shpesh këta vrojtues ishin studentë.

Sipas tij, kalimi te teknologjia ka ulur numrin e alarmeve të rreme.

“Një kamerë e asistuar nga inteligjenca artificiale mund të

dallojë me pothuajse siguri të plotë ndryshimin mes tymit dhe pluhurit të ngritur, për shembull, nga një traktor në një fushë”.

Kamerat kanë gjithashtu një rreze të madhe veprimi, duke zbuluar zjarre deri në 20 kilometra larg.

Në Gironde, sistemi është instaluar nga kompania Midgard, ndërsa në zona të tjera të Francës përdoret një tjetër kompani franceze, FireTracking.

“Menjëherë sapo sistemi zbulon një zjarr, zjarrfikësit marrin një alarm në telefon. Ata hapin aplikacionin dhe shohin atë që kamera po regjistron me zmadhim 40-fish”, shpjegon drejtori ekzekutiv i FireTracking, Jean-Simon Chaudier.

Krahas videos në kohë reale, aplikacioni tregon një hartë me vendndodhjen e saktë të zjarrit, pozicionin e banesave pranë tij dhe një simulim se si pritët të përhapet zjarri minutë pas minute, duke marrë parasysh motin, lagështinë dhe faktorë të tjerë.

Dhe çdo minutë është vendimtare.

“Gjatë 10 ditëve të fundit kemi marrë reagime nga një zjarrfikës që na tha se inteligjenca artificiale kishte zbuluar shtatë zjarre 15 minuta përpara telefonatës së parë. Nëse i ndihmon një zjarrfikësi të fitojë 15 minuta, kjo është diferenca mes një katastrofe dhe një zjarri që mund të kufizohet në dy ose tre hektarë”, thotë Chaudier.

“Pas një minute mund ta shuash një zjarr me një gotë ujë, pas dy minutash të duhet një depozitë uji, ndërsa pas tre minutash duhet të dërgosh një Canadair”, shpjegon ai, duke iu referuar avionëve amfibë që marrin ujë nga lumenjtë, liqenet dhe deti për ta hedhur mbi flakë.

Kamerat e FireTracking aktualisht monitorojnë rreth një milion hektarë tokë, kryesisht në Francë.

Në departamentin francez Indre-et-Loire, kompania ka instaluar 11 pika zbulimi.

“Janë shpenzuar gjithsej 1.2 milionë euro për të mbuluar të gjithë zonën prej 6 mijë kilometrash katrorë”, thotë Chaudier. Kjo zonë është kryesisht bujqësore dhe zjarret në kultura bujqësore janë një problem i madh. Sipas tij, vetëm në këtë departament ndodhin rreth 300 zjarre të tilla çdo vit.

Zbulimi i zjarreve me inteligjencë artificiale pritët të përmirësohet edhe më shumë në vitet e ardhshme. Shërbimi francez i mbrojtjes civile po teston programin Condor, i cili përdor dronë me energji diellore që kryejnë patrullime të vazhdueshme me kamera optike dhe inteligjencë artificiale.

Ka gjithashtu projekte me sensorë të vendosur mes pemëve. Një shembull është projekti spanjoll SenForFire, i cili mat gazrat që çlirohen para se flakët të bëhen të dukshme.

Sa u përket dronëve, zjarrfikësi Guillaume Millet thotë se në

Francë ata po testohen për shpëtimet në det, duke hedhur jelekë shpëtimi dhe pajisje emergjence, por ende nuk ekziston një teknologji dronësh që të ketë arritur këtë nivel për shuarjen e zjarreve.

“Në fakt, dobia e teknologjisë në këtë fushë është shumë e kufizuar. Ajo mund të na ndihmojë me zbulimin, por nuk është teknologjia që i fik zjarret; duhen njerëz që të tërheqin zorrët e ujit përmes pyllit dhe të sulmojnë flakët”, thotë Millet.

Sipas tij, as avionët nuk mund ta zëvendësojnë këtë punë.

“Kur një Canadair hedh 6 mijë litra ujë mbi një zjarr pyjor, ai ul intensitetin e tij, por më pas janë zjarrfikësit në tokë që duhet të përfundojnë punën që nisi avioni”.

Franca po mësohet gjithashtu me përdorimin e avionëve Dash, të cilët spërkasin retardantë zjarri (fosfat amoniumi në formën e një pluhuri portokalli) përpara flakëve, duke penguar përhapjen e shpejtë të zjarrit në bimësi.

Por edhe kjo nuk zëvendëson fuqinë dhe ndërhyrjen e ekipeve në terren.

Një kompani franceze, Daidelos, po përpiqet të sigurojë investime për zhvillimin e një droni të rëndë me motor benzine. Nëse projekti realizohet, ai do të mund të qëndrojë mbi një zjarr dhe të spërkasë deri në 1.2 tonë ujë.

Kompani të tjera po zhvillojnë gjithashtu dronë që hedhin granata të posaçme, të cilat shpërthejnë kur bien në kon-

takt me temperatura ekstreme dhe mbulojnë zonën përreth me një pluhur kimik që fik, ftoh dhe ndërpret procesin e djegies.

Qëllimi është krijimi i një reaktimi të parë automatik, ku zbulimi i zjarrit dhe aktivizimi i dronëve të jetë aq i shpejtë sa zjarret të mund të shuhet që në momentet e para.

Megjithatë, kjo teknologji nuk do të mund të përballët me një zjarr të madh pasi ai të ketë marrë përmasa të mëdha.


Studiues francezë po punojnë gjithashtu për dronë që mund të afrohen pranë flakëve, jo për t'i shuar ato drejtpërdrejt, por për të mbledhur informacione të rëndësishme mbi situatën: rrezikun nga tymi, ndryshimet e papritura të motit, shembjen e pemëve ose ndërtesave të djegura, përpara se zjarrfikësit të ndërhyjnë.

Teknologjia tashmë po ndihmon zjarrfikësit të zbulojnë zjarret më shpejt dhe të reagojnë më me efikasitet. Në të ardhmen ajo mund ta bëjë punën e tyre më pak të rrezikshme.

Por zëvendësimi i tyre duket i pamundur, sipas zjarrfikësit të Gironde, Guillaume Millet.

“Janë gjithmonë zjarrfikësit në terren, ata që tërheqin zorrët e ujit dhe shuajnë zjarret”, thotë ai.

Kjo ka qenë e vërtetë që nga krijimi i brigadës së parë moderne të zjarrfikësve në Holandë në vitet 1670 dhe nuk pritët të ndryshojë së shpejti.



Gentrit Hetemaj transferohet te Llapi deri më 2029

PODUJEVË, 7 GUSHT - Mbrojtësi Gentrit Hetemaj është lojtari më i ri i KF Llapit, me të cilin ka nënshkruar kontratë deri në

vitin 2029. 19-vjeçari, i formuar në futbollin gjerman dhe pjesë e përfaqësueseve të Kosovës në grupmoshat U15, U17 e U19, i

bashkohet skuadrës nga Podujeva për një kapitull të ri në karrierën e tij. Hetemaj ka qenë pjesë e akademisë të

Hoffenheimit dhe Darmstadt, ndërsa transferimi i tij te Llapi është realizuar nga "KA-Sport Management".



NIS SEMINARI I FIFA-S PËR GJYQTARËT E FUTBOLLIT TË KOSOVËS

PRISHTINË, 7 GUSHT - Federata e Futbollit e Kosovës (FFK) ka nisur seminarin dyditorë të FIFA-s për gjyqtarët e futbollit, i cili është duke u mbajtur në Prishtinë. Ky seminar shënon fillimin e përgatitjeve për edicionin e ri garues 2026/27 dhe synon avancimin e njohurive teknike, fizike dhe profesionale të gjyqtarëve kosovarë.

Punimet e këtij seminary u hapën nga presidenti i FFK-së, Agim Ademi, ndërsa ligjërimet janë duke u udhëhequr nga instruktori i



FIFA-s, Alan Snoddy dhe eksperti i përgatitjes fizike, Simon Breivik. Programi përfshin temat më aktuale të

ndarjes së drejtësisë, ndryshimet në rregullat e lojës për edicionin 2026/27, analizën e incidenteve,

përdorimin e VAR-it, integritetin e zyrtarëve të ndeshjes, përgatitjen fizike, menaxhimin e lojës dhe

analizën e situatave nga kampionati vendor.

Pjesë e rëndësishme e seminarit janë edhe testet fizike, të cilat zhvillohen sipas standardeve të FIFA-s, duke siguruar që gjyqtarët të jenë maksimalisht të përgatitur për sfidat e sezonit të ri. Përmes organizimit të seminareve të tilla, FFK-ja vazhdon të investojë në zhvillimin profesional të gjyqtarëve, duke synuar rritjen e cilësisë së arbitrimin në garat vendore dhe përgatitjen e tyre për angazhime në arenën ndërkombëtare.

DRITA TRIUMFON BINDSHËM NDAJ TRE FIORIT, ME NJË KËMBË NË 'PLAY-OFF' TË LIGËS SË KONFERENCËS



FIorentino, 7 GUSHT - Kampionia e Kosovës në futboll, FC Drita, ka shënuar një fitore të madhe në udhëtim ndaj Tre Fiorit, duke e mposhtur skuadrën nga San Marino me rezultat 4:1 në ndeshjen e parë të raundit të tretë kualifikues të Ligës së Konferencës.

Gjilanasit kanë zhvilluar një paraqitje të mirë dhe me këtë sukses kanë bërë një hap të

rëndësishëm drejt kualifikimit në "play-off"-in e kësaj gare.

Drita ishte skuadra më kërkuese gjatë gjithë takimit dhe krijoi disa mundësi për gol, por ishte Tre Fiori që ka kaluar e para në epërsi. Kapiteni i skuadrës nga San Marino, Matteo Prandelli, ka realizuar në minutën e 56-të, duke i dhënë avantazhin vendasve.

Megjithatë, reagimi i kampionëve

të Kosovës ishte i menjëhershëm. Vetëm pesë minuta më vonë, Raddy Ovouka ka barazuar rezultatin në 1:1, pasi ka shfrytëzuar topin e kthyer nga portieri kundërshtar. Drita nuk është ndal dhe vetëm dy minuta më pas ka përmbysur rezultatin. Blerim Krasniqi ka shënuar për 2:1, duke e vendosur skuadrën gjilanasë në epërsi.

Në minutat e fundit të ndeshjes,

Drita e ka vulosur fitoren e thellë përmes Besnik Krasniqit. Ai ka realizuar golin e tretë në minutën e 82-të, ndërsa në kohën shtesë ka shënuar edhe nga pika e bardhë për rezultatin përfundimtar 4:1.

Me këtë fitore, Drita ka krijuar një avantazh të madh para ndeshjes së kthimit, e cila do të zhvillohet javën e ardhshme në Prishtinë.

UEFA ZYRTARIZON DY RREGULLA TË REJA QË PREKIN TË GJITHA GARAT EVROPIANE

NYON, 7 GUSHT - UEFA ka miratuar dy ndryshime të rëndësishme në rregulloren e saj, të cilat do të zbatohen duke filluar nga sezoni 2026/27 në të gjitha kompeticionet evropiane për klube. Një nga ndryshimet prek

sistemin e kartonëve të verdhë. Sipas rregullit të ri, një futbollist do të pezullohet pasi të grumbullojë katër kartonë të verdhë, në vend të tre, siç parashikohej deri më tani. Pas këtij pezullimi të parë, çdo

pezullim i radhës do të vijë pas çdo dy kartonëve të tjerë të verdhë, pra pas kartonit të gjashtë, të tetë dhe në të njëjtën mënyrë edhe më tej. Ndryshimi tjetër lidhet me paraqitjen e kohës në stadium. UEFA ka vendosur të

heqë praktikën e ndalimit të kronometrit në minutat 45:00 dhe 90:00. Me hyrjen në fuqi të rregullit të ri, ora zyrtare do të vazhdojë të numërojë edhe gjatë kohës shtesë, duke shfaqur minutat shtesë në kohë reale, një sistem që përdoret

prej kohësh në futbollin anglez. Sipas UEFA-s, këto risi synojnë ta bëjnë zhvillimin e ndeshjeve më të qartë dhe më transparent, duke përmirësuar njëkohësisht funksionimin e garave evropiane për lojtarët, klubet dhe tifozët.

Viniciusi vazhdon kontratën me Real Madridin

MADRID, 7 GUSHT - Real Madridi ka konfirmuar zyrtarisht vazhdimin e bashkëpunimit me Vinicius Jr., duke blinduar njërin prej yjeve kryesorë të skuadrës për vitet e ardhshme.

Klubi madrilen ka njoftuar se ka arritur marrëveshje me sulmuesin brazilian për rinovimin e kontratës, e cila tashmë do ta mbajë atë në "Santiago Bernabeu" deri më

30 qershor 2032.

Vinicius Jr. i është bashkuar Real Madridit në korrik të vitit 2018, kur ishte vetëm 18-vjeçar. Që atëherë, ai është shndërruar në një prej futbollistëve më të

rëndësishëm në historinë e fundit të klubit. Në tetë sezonet me fanellën e bardhë, braziliani ka zhvilluar 375 ndeshje, duke realizuar 128 gola dhe duke fituar plot 14 trofe.





Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook  www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553

PRISHTINË



Lume's Details

Estetik & Depilim



044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

[lumesdetails](https://www.instagram.com/lumesdetails)

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “auraarchitectura” L.L.C. pronar Atike Çetin me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 812434520 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “auraarchitectura” D.O.O. Atike Çetin Pristina donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812434520 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “auraarchitectura” L.L.C. with owner Atike Çetin with headquarters Pristina, has come to the decision to quit its business: 812434520 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Qamil Karavidaj shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore “Gjergj Kastrioti” në Mazdrek.
- Valmir Karavidaj shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore “Gjergj Kastrioti” në Mazdrek.
- Elton Halili shpall të pavlefshme dëftesën e klasës së 11 të shkollës së mesme të lartë të mjekësisë “Dr. Xheladin Deda”.
- Istref Hysni Nebiu shpall të pavlefshme Diplomën e Inxhinier i Diplomuar i Makineris në UB-me nr. 332.
- Shkendije Lushaj nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.l.m.”Hysni Zajmi” Gjakovë.
- Maurita Koca nga Bishtazhina KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e kl.10 të Gjmnazit “Hajdar Duishi” Gjakovë.
- Bedri Zeneli nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën dhe certifikatën e notave të Gjmnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.
- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.
- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)
- Lëshoj banesë me qira, pent-house. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.



ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1906

Columbus, Georgia, USA
Since 1906 0.5L

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

